



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
KOMISIONERI PËR TË DREJTEN E INFORMIMIT DHE MBROJTJEN E TË  
DHËNAVE PERSONALE

Nr. 1666/13 Prot

Tiranë, më 28 / 12 / 2014

V E N D I M

Nr. 8, datë 28 / 12 / 2014

Në mbështetje të neneve 29, 30 dhe 32 të ligjit nr. 9887, datë 10.03.2008 "Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale" i ndryshuar, si dhe neneve 80-104 të ligjit nr. 8485, datë 12.05.1999 "Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë", pas shqyrtimit të materialit dhe mendimit paraprak të Drejtorisë së Hetim Inspektimit në ngarkim të kontrolluesit "Sigma Vienna Insurance Group" sh.a, e shndërruar në shoqëri të re "Sigma Interlbanian Vienna Insurance Group" sh.a, regjistruar pranë QKR-së me NIPT J 913290030.

VËREJ SE :

Në zbatim të urdhrin nr. 154 datë 01.10.2014, është ushtruar kontrolli administrativ pranë subjektit juridik "Sigma Interlbanian Vienna Insurance Group" sh.a. Kontrolli administrativ ka filluar kryesisht nga Zyra e Komisionerit dhe është njoftuar paraprakisht, me objekt; "Zbatimi nga ana e kontrolluesit i ligjit nr. 9887 datë 10.03.2008 "Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale" i ndryshuar, si dhe akteve të miratuara nga Komisioneri gjatë kryerjes së aktivitetit të tij".

Kontrolluesi është person juridik jopublik, me veprimtari në fushën e sigurimeve, bazuar në ligjin nr. 52/2014 "Për veprimtarinë e sigurimit, dhe risigurimit" dhe akteve të tjera normative të dala në zbatim të tij nga Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare (AMF). Kontrollusi "Sigma Interlbanian Vienna Insurance Group" sh.a, gjatë ushtrimit të aktivitetit mbledh, përpunon, ruan të dhëna personale për subjektet e të dhënave të cilët kanë lidhje me aktivitetin e tij.

Komisioneri për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale pas shqyrtimit të procesverbalit të kontrollit administrativ dhe provave të administruara konstaton se:

1. Kontrolluesi gjatë procesit të mbledhjes së të dhënave personale, në policat e sigurimit të detyrueshëm dhe ato vullnetare nuk realizon detyrimin për informim të subjektit të të dhënave personale.

Në faqen e tij të internetit [www.sigma-al.com](http://www.sigma-al.com) nuk ka publikuar "politikat e privatësisë", me qëllim informimin e personave që vizitojnë faqen, mbi mënyrat e përpunimit të të dhënave personale, masat e sigurisë dhe ruajtjes së konfidencialitetit, të drejtat e subjekteve të të dhënave dhe detyrimet e kontrolluesit, detyrë e lënë më parë për zbatim nëpërmjet Rekomandimit nr. 68 datë 18.08.2014 të Komisionerit për Mbrojtjen e të Dhënave Personale.



Shkeljet ligjore të kryera nga kontrolluesi të cilat lidhet me detyrimin për informim të subjekteve të të dhënave personale, gjatë procesit të mbledhjes së këtyre të dhënave, në policat për sigurimin e detyrueshëm të mbajtësve të mjeteve motorike për përgjegjësi ndaj palëve të treta (TPL), certifikatë ndërkombëtare e sigurimit motorik (karton jeshil), police kufitare, kontratat vullnetare (sigurim shëndeti, prone, sigurim kasko, sigurim oferte, sigurim nga zjarri etj), si dhe mospublikimi i rubrikës në faqen e internetit [www.sigma-al.com](http://www.sigma-al.com), kanë të bëjë me moszbatimin e nenit 18 të ligjit nr. 9887 datë 10.03.2008 “Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale” i ndryshuar.

Sipas përcaktimeve dhe detyrimeve që rrjedhin nga ky nen, kontrolluesi, kur mbledh të dhëna personale, duhet të informojë subjektin e të dhënave për fushën dhe qëllimin, për të cilin do të përpunohen të dhënat personale, për personin që do t’i përpunojë të dhënat, për mënyrën e përpunimit etj. Kur kontrolluesi përpunon të dhëna personale, të marra nga subjekti i të dhënave, ai është i detyruar të informojë subjektin e të dhënave nëse dhënia e të dhënave personale është e detyrueshme apo vullnetare. Nëse subjekti i të dhënave, në bazë të një akti ligjor ose nënligjor, është i detyruar të japë të dhëna personale për përpunim, kontrolluesi e informon edhe rreth këtij fakti, si dhe rreth pasojave të refuzimit të dhënies së të dhënave personale.

Informimi në kohën e duhur dhe sa më i saktë i subjekteve të të dhënave personale nga kontrolluesit është një detyrim shumë i rëndësishëm në drejtim të respektimit të privatësisë dhe përpunimit të ligjshëm të të dhënave personale. Informacioni duhet të jepet i saktë dhe sa më i shpejtë që të jetë e mundur.

Gjithashtu edhe publikimi i rubrikës “politikat e privatësisë” në faqen e internetit të kontrolluesit ka për qëllim informimin e individëve subjekte të të dhënave personale që aplikojnë online ose personave që vizitojnë/aksesojnë faqen.

Mos realizimi i detyrimit ligjor për informim nga kontrolluesi iu mohon subjekteve të të dhënave personale të drejtën për tu informuar rreth të dhënave që ata deklarojnë pranë kontrolluesit, mbi mënyrat e mbledhjes, përpunimit, ruajtjes, masat e marra për sigurinë e të dhënave personale, faktin se çfarë bëhet me të dhënat personale të tyre, kush po i përpunon të dhënat personale, ku dhe kujt i përhapen të dhënat e tyre, të drejtat e subjekteve të të dhënave personale dhe detyrimet e kontrolluesit në kuadër të mbrojtjes së privatësisë.

2. Kontrolluesi në kontratat e lidhur me punëmarrësit, si dhe në të gjitha marrëveshjet e tij kontraktuale me të tretë nuk ka parashikuar, klauzola, dispozita mbi parimet e mbrojtjes së të dhënave personale.

Kontrolluesi në marrëveshjen e shërbimit lidhur me “Vig Services” Shqipëri nuk ka respektuar detyrimet e nenit 20 të ligjit 9887 datë 10.03.2008 Për mbrojtjen e të dhënave personale si dhe udhëzimit nr. 19 datë 03.08.2012 “Mbi rregullimin e marrëdhënieve mes kontrolluesit dhe përpunuesit në rastet e delegimit të përpunimit të të dhënave dhe përdorimin e një kontrate tip në rastet e këtij delegimi”.

Këto shkelje kanë të bëjnë me mos respektimin e detyrimeve që rrjedhin nga neni 20 i ligjit nr. 9887 datë 10.03.2008 “Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale” i ndryshuar, si dhe udhëzimit nr. 19 datë 03.08.2012 “Mbi rregullimin e marrëdhënieve mes kontrolluesit dhe përpunuesit në rastet e delegimit të përpunimit të të dhënave dhe përdorimin e një kontrate tip në rastet e këtij delegimi”.

Sipas përcaktimeve të këtij neni, kontrolluesit e të dhënave personale për të garantuar përdorimin e ligjshëm dhe të sigurt të të dhënave, kur futen në marrëdhënie me palë të treta në rastet e delegimit të shërbimeve, duhet të kushtëzojnë këto palë dhe të vendosin detyrime ndaj tyre, për përpunimin e të dhënave vetëm në përputhje me udhëzimet e kontrolluesit, të dhënat të mos transmetohen, përveç kur kontrolluesi e lejon një gjë të tillë, të kushtëzojë palën e tretë për të marrë të gjitha masat e sigurisë, sipas këtij ligji dhe të punësojë



operatorë, të cilët kanë detyrimin për ruajtjen e fshehtësisë, të krijojë, në marrëveshje me kontrolluesin, kushtet e nevojshme teknike dhe organizative për përmbushjen e detyrimeve të kontrolluesit, për të siguruar të drejtat e subjekteve të të dhënave personale, t'i dorëzojë kontrolluesit, pas përfundimit të shërbimit të përpunimit, të gjitha rezultatet e përpunimit dhe dokumentacionit, që përmban të dhëna, ose t'i mbajë apo t'i shkatërrojë ato me kërkesë të kontrolluesit.

3. Kontrolluesi nuk ka përditësuar "Formularin e njoftimit" të bërë pranë Zyrës së Komisionerit në disa nga rubrikat; nuk është deklaruar kategoria e subjekteve të të dhënave "punonjës", nuk ka deklaruar kategori të ndryshme të të dhënave personale që përpunon, nuk ka deklaruar të dhënën personale mbi "gjendjen gjyqësore".

Shkelja ligjore e bërë nga kontrolluesi në këtë rast lidhen me nenin 21 të ligjit nr. 9887 datë 10.03.2008 "Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale" i ndryshuar.

Kontrolluesit duhet të njoftojë Komisionerin për përpunimin e të dhënave personale, për të cilat është përgjegjës. Njoftimi duhet të bëhet para se kontrolluesi të përpunojë të dhënat për herë të parë ose kur kërkohet ndryshimi i gjendjes së njoftimit të përpunimit, sipas nenit 22 të këtij ligji, të njoftuar më parë.

Mos përditësimi i njoftimi nga ana e kontrolluesit, lidhet me mungesën e transparencës ndaj publikut të kontrolluesit në raport me subjektet e të dhënave personale. Subjektet e të dhënave personale nëpërmjet "Regjistrin Elektronik të Njoftimeve", i cili i është hapur për publikun në faqen zyrtare [www.kmdp.al](http://www.kmdp.al) të Zyrës së Komisionerit, kanë mundësinë të njihen me të dhënat personale që kontrolluesi përpunon, (kategoritë e të dhënave personale, mjetet e përpunimit, subjektet të cilët përpunojnë të dhënat, sigurinë e të dhënave personale etj.). Komisioneri për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale, nëpërmjet "Regjistrin Elektronik të Njoftimeve", mbikëqyr dhe monitoron kontrolluesit për përpunimin e të dhënave personale, në përputhje me ligjin për mbrojtjen e të dhënave personale, duke respektuar dhe garantuar të drejtat dhe liritë themelore të njeriut.

4. Kontrolluesi "Sigma Inter-Albanian Vienna Insurance Group" sh.a nuk ka hartuar rregullore të veçantë, ku të përcaktohen qartë rregulla për mbledhjen, përpunimin, mbrojtjen e të dhënave personale, kohën e ruajtjes, procedurat e asgjësimit, sigurinë dhe konfidencialitetin e të dhënave, si dhe nuk ka përcaktuar rregulla për mbledhjen, përpunimin e të dhënave personale nëpërmjet video-surveimit (regjistrim me kamera CCTV), në respekt të ligjit nr. 9887 datë 10/03/2008, "Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale" i ndryshuar.

Shkeljet ligjore të bërë nga kontrolluesi në këtë rast lidhen me nenet 27, 28 të ligjit nr. 9887 datë 10.03.2008 "Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale" i ndryshuar dhe udhëzimin nr. 3 datë 05/03/2010 të Komisionerit, "Përpunimi i të dhënave personale me sistemin e video surveimit në ndërtesa dhe mjedise të tjera", i ndryshuar.

Mungesa e rregullave dhe e hartimit të rregullores së veçantë, në të cilën të jenë shprehur përcaktimet dhe detyrimet që rrjedhin nga nenet 27, 28 të ligjit nr. 9887 datë 10.03.2008 "Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale" i ndryshuar, të cilat detyrojnë kontrolluesin të marrë masa teknike dhe organizative për përcaktimin e funksioneve ndërmjet njësive organizative dhe operatorëve për përdorimin e të dhënave, përcaktimin e aksesit, përcaktimi i personave të autorizuar që hyjnë në të dhënat dhe programet e ndryshme që aplikon kontrolluesi, tregojnë për mungesën e masave të sigurisë dhe shkallës së ulët të



konfidencialitetit që ka kontrolluesi në procesin e mbledhjes përpunimit dhe ruajtjes së të dhënave personale. Dokumentimi në formë të shkruar i këtyre masave tekniko-organizative dhe zbatimi i tyre në praktikë është garanci për mbrojtjen e të dhënave personale në përputhje me ligjin, gjatë ushtrimit të veprimtarisë së kontrolluesit.

Mbledhja, përpunimi dhe ruajtja e të dhënave personale duhet të kryhen sipas parimit të respektimit dhe garantimit të te drejtave dhe lirive themelore të njeriut dhe në veçanti të drejtës së ruajtjes së jetës private.

Të gjitha shkeljet e konstatuara gjatë kontrollit administrativ, rezultojnë të provuara me provat e administruara gjatë kontrollit, si dhe janë pasqyruar në procesverbali i kontrollit administrativ.

Në zbatim të neneve 93-96 të ligjit nr. 8485, datë 12.05.1999 “Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë”, në ambientet e zyrës së Komisionerit në datën 02/12/2014, është zhvilluar seanca dëgjimore me kontrolluesin “Sigma Interlbanian Vienna Insurance Group” sh.a.

Nga observacioni i paraqitur nga përfaqësuesi me autorizim i kontrolluesit, dokumentacionit bashkëlidhur tij, parashtimeve të bëra në seancë dëgjimore rezulton se;

Kontrolluesi “Sigma Interlbanian Vienna Insurance Group” sh.a, pranon që konstatimet e grupit të kontrollit administrativ janë të sakta, nuk kundërshtohet faktin që shkeljet e konstatuara janë kryer, si dhe rezulton se është reflektuar mbi disa nga shkeljet e konstatuara kështu;

- Kontrolluesi ka hartuar “Rregulloren e re të brendshme të funksionimit të kompanisë”, në të cilën është përfshirë një kapitull i veçantë në lidhje me mbrojtjen e të dhënave personale.
- Kontrolluesi ka reflektuar në faqen e internetit [www.sigma-al.com](http://www.sigma-al.com), duke vendosur rubrikën “politikat e privatësisë”.
- Ka miratuar ndryshimin e marrëveshjes/kontratës me shoqërinë e shërbimit të trajtimit të dëmeve “VIG services”, duke përfshirë në to kërkesat për mbrojtjen e të dhënave.
- Kontrolluesi po merr masa edhe për ndërhyrjen në “Policat e sigurimit të detyrueshëm TPL” për të shtuar informimin në këto polica.

Përfaqësuesi i kontrolluesit lidhur me informimin në policat e sigurimit pretendon se realizimi i kësaj detyre ka disa vështirësi për shkak se kërkon miratimin e formatit të policave pranë Byrosë Shqiptare të Sigurimit (Asamblesë së Përgjithshme) dhe Autoritetit të Mbikëqyrjes Financiare (AMF).

Sa i përket këtij pretendimi, ligji nr. 52/2014 “Për veprimtarinë e sigurimit, dhe risigurimit”, përcakton se policat e sigurimit hartohen nga kontrolluesi dhe nuk ka detyrim që këto polica të miratohen BSSH apo nga Autoriteti Mbikëqyrës Financiar (AMF). Kontrolluesi ka detyrë vetëm të informojë AMF për modelet e policave që ai përdor.

Kontrolluesi duhet të kishte përfshirë tek kushtet e policës informimin e subjekteve të të dhënave (klientë). Informimi në kohën e duhur dhe sa më i saktë i subjekteve të të dhënave personale nga kontrolluesit është një detyrim shumë i rëndësishëm në drejtim të respektimit të privatësisë dhe përpunimit të ligjshëm të të dhënave personale.

Si përfundim konkludoj se; shkeljet e konstatuara gjatë ushtrimit të kontrollit administrativ pranë kontrolluesit “Sigma Interlbanian Vienna Insurance Group” sh.a, në kuptim të nenit 39 të ligjit nr. 9887 datë 10.03.2008 “Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale” i ndryshuar, përbëjnë **“kundërvajtje administrative”** dhe sanksionohen me gjobë;



- Kontrolluesit, që nuk përmbushin detyrimin për të informuar, të përcaktuar në nenin 18 të këtij ligji, dënohen me 10 000 deri në 300 000 lekë.
- Kontrolluesit ose përpunuesit, që nuk zbatojnë detyrimet e përcaktuara në nenin 20 të këtij ligji, dënohen me 10 000 deri në 300 000 lekë.
- Kontrolluesit ose përpunuesit, që nuk përmbushin detyrimin për të njoftuar, sipas përcaktimit në nenin 21 të këtij ligji, dënohen me 10 000 deri në 500 000 lekë.

Për zgjedhjen e masës së gjobës, Komisioneri ka parasysh faktin se shkeljet e konstatuara janë serioze, ato lidhen me të drejtën e subjekteve të të dhënave personale për informim si një e drejtë parësore në zbatim të ligjit, me sigurinë dhe konfidencialitetin e të dhënave personale, me seriozitetin e zbatimit të detyrave që dalin nga Rekomandimet e Komisionerit, zbatimin e ligjit nr. 9887 datë 10/03/2008 "*Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale*" i ndryshuar, nenin 39 /2 në të cilin parashikohet se; "*Personat juridikë, për kundërvajtjet e mësipërme, dënohen me dyfishin e gjobës së përcaktuar në pikën 1 të këtij neni* faktin që kontrolluesi ka qenë bashkëpunues gjatë ushtrimit të këtij kontrollit administrativ dhe ka marrë masa për rikuperimin e disa prej shkeljeve të konstatuara.

#### **PËR KËTO ARËSYE:**

Në zbatim të neneve 18/2, 20, 21, 29, 30/2, 31, 39/1/b/ç/, 39/2, 39/4, 40 e 41, të ligjit nr. 9887, datë 10/03/2008 "*Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale*", si dhe 107-109 të ligjit nr. 8485, datë 12.05.1999 "*Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë*"

#### **V E N D O S A**

1. Dënimin e kontrolluesit "*Sigma InterAlbanian Vienna Insurance Group*" sh.a me gjobë në vlerën 20 000 (njëzetë mijë) lekë, për shkelje të detyrimit të përcaktuar në **nenin 18** të ligjit nr. 9887 datë 10.03.2008 "*Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale*" i ndryshuar.
2. Dënimin e kontrolluesit "*Sigma InterAlbanian Vienna Insurance Group*" sh.a, me gjobë në vlerën 20 000 (njëzetë mijë) lekë, për shkelje të detyrimit të përcaktuar në **nenin 20** të ligjit nr. 9887 datë 10.03.2008 "*Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale*" i ndryshuar.
3. Dënimin e kontrolluesit "*Sigma InterAlbanian Vienna Insurance Group*" sh.a me gjobë në vlerën 50 000 (pesëdhjetë mijë) lekë për shkelje të detyrimit të përcaktuar në **nenin 21** të ligjit nr. 9887, datë 10.03.2008 "*Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale*" i ndryshuar.

